



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 19 dhjetor 2016
Nr. ref.:RK1021/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI105/15

Parashtrues

Mehmet Bajraktari dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Kryeprokurorit të Shtetit,
KMLC. nr. 44/15, i 10 prillit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mehmet Bajraktari, Hamit Bajraktari, Brahim Bajraktari dhe Arxhend Bajraktari (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës) nga Gllogoci, të përfaqësuar nga Alexander Borg Oliver, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Njoftimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, KMLC. nr. 44/15, të 10 prillit 2015, Aktvendimin Rev. nr. 272/14, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të cilin, përfaqësuesi i parashtruesve e ka pranuar më 23 dhjetor 2014. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu, kanë kontestuar edhe aktvendimet e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2052/2012, të 3 shtatorit 2013 dhe Ca. nr. 3824/13, të 3 korrikut 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesve për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuar, të cilat pretendohen të kenë shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe të drejtave të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt], nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive], nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] si dhe me nenin 1 të Protokollit 1 [Mbrojtja e Pronës].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 gusht 2015, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 shtator 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI105/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI105/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 20 tetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 3 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës, me vendim, caktoi anëtar të Kolegjit shqyrtues gjyqtarin Bekim Sejdiu në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator 2016 kishte dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit.

9. Më 20 tetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

10. Më 26, përkatësisht 30 prill 2001, parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur padi të ndara në Gjykatën Komunale në Glogoc kundër Komunes së Glogocit dhe Kompanisë për qarkullimin e derivateve “Kosova Petrol” lidhur me vërtetimin e pronësisë për ngastrat kadastrë të cekura si në padi, për të cilat kanë pretenduar se në mënyrë joligjore ju kishin eksproprijuar atyre dhe babait të tyre në vitin 1976, nga e paditura Komuna e Glogocit. Parashtruesit në padi kishin theksuar se ata ende disa pjesë të patundshmërisë i kanë në posedim dhe në të kanë ndërtuar objekte të ndryshme.
11. Paditë e parashtruesve ishin regjistruar në Gjykatë si C. nr. 52/2001 dhe C. nr. 55/2001, mirëpo, Gjykata, më 25 maj 2001, bëri bashkimin e lëndëve në një të vetme, duke i regjistruar me numrin karakteristik C. nr. 52-55/2001, për shkakun se kanë qenë të natyrës së njëjtë juridike.
12. Më 3 shtator 2001, Gjykata Komunale në Glogoc, me Aktgjykimin C. nr. 52-55/2001 ka aprovuar padinë e parashtruesve dhe ua ka njohur të drejtën e pronësisë mbi ngastrat e cekura në padi.
13. Sipas parashtruesve të kërkesës, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. 49-01/2001 (të cilin nuk e kanë bashkëngjitur në shkresat e lëndës, e që kanë theksuar se do ta sjellin më vonë), “*tërësisht për shkaqe procedurale*” e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim në Gjykatën Komunale në Glogoc.
14. Më 29 dhjetor 2005, Gjykata Komunale në Glogoc, me Aktgjykimin C. nr. 4/02, në procesin e rigjykimit, e ka refuzuar si të pabazuar padinë e parashtruesve.
15. Më 14 gusht 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 256/2006, vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 4/02 të shkallës së parë dhe refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve.
16. Më 30 korrik 2009, Gjykata Supreme me Aktgjykimin, Rev. nr. 603/2008, refuzoi si të pabazuar revizionin e ushtruar nga parashtruesit kundër aktgjykimit të shkallës së dytë.
17. Më 12 prill 2010, parashtruesit nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar kanë paraqitur në Gjykatën e Apelit të Kosovës kërkesë për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 603/2008.
18. Më 5 maj 2010, parashtruesit kanë plotësuar kërkesën për përsëritje të procedurës.

19. Më 3 shtator 2013, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 2052/12, refuzoi si të pabazuar kërkesën për përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Supreme.
20. Më 9 tetor 2013, përfaqësuesi i parashtruesve në përputhje me udhëzimin juridik paraqiti ankesë në trupin gjykues të Gjykatës së Apelit, duke kërkuar shfuqizimin e Aktvendimit për refuzimin e kërkesës për përsëritjen e procedurës.
21. Më 8 korrik 2014, Kolegji i Gjykatës së Apelit, me Aktvendimin CA. nr. 3284/13, refuzoi si të pathemeltë ankesën e përfaqësuesit të parashtruesve dhe vërtetoi Aktvendimin e 3 shtatorit 2013.
22. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit kanë parashtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës, kërkesë për revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, duke kërkuar njëkohësisht shfuqizimin e të dyja aktvendimeve të Gjykatës së Apelit me të cilën refuzohej kërkesa për përsëritjen e procedurës.
23. Më 20 nëntor 2014, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 272/14, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruar për revizion.
24. Më 26 mars 2015, përfaqësuesi i parashtruesve paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën për revizion.
25. Më 10 prill 2015, Prokurori i Shtetit, në Njoftimin e vet KMLC nr. 44/15, drejtuar zyrës së përfaqësuesit të parashtruesve, konstatoi se nuk ka gjetur që ka bazë për të ushtruar mjetin e jashtëzakonshëm juridik-kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, pasi që *“sipas nenit 245.3 të LPK nuk lejohet një kërkesë e tillë kundër vendimit gjyqësor me të cilin është vendosë lidhur me revizionin”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe e të drejtës së pronës që garantohen me Kushtetutën e Kosovës dhe KEDNJ-së, kanë ndodhur për shkak se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh të gjitha faktet e paraqitura që lidhen me pronën, duke shtuar se deprivimi nga prona, fillimisht nga Komuna është bërë pa asnjë dokument të shkruar dhe ka qenë faktik. Më vonë, gjykatat nuk kanë marrë për bazë kontratat e vërtetuara që lidhen me çështjen e trashëgimisë të pronave kontestuese e që janë vërtetuar në vet gjykatat e rregullta. Gjithashtu, pretendohet se nuk është trajtuar drejt çështja e eksproprijimit dhe, se gjykimi ka pasur elemente të njëanshmërisë për shkak të pjesëmarrjes së një gjyqtareje në faza të ndryshme gjykimi.
27. Parashtruesit kanë kërkuar nga Gjykata që të konstatojë shkelje të të drejtave të njeriut sikur janë theksuar në kërkesë dhe që Gjykata *“të nxjerrë udhëzime të tilla shtesë të mjaftueshme të cilat i konsideron të nevojshme për zbatimin e duhur të drejtësisë në rrethanat e rastit dhe inter alia të sigurojë që*

veçanërisht të drejtat e pronësisë dhe posedimit u janë rikthyer parashtruesve në mënyrë të plotë”.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Në mënyrë që të gjykojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse ata i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson, nëse parashtruesit e kanë paraqitur kërkesën brenda afatit të përcaktuar kohor me këtë rast i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.*

31. Në mënyrë që të verifikojë nëse parashtruesit kanë parashtruar kërkesën brenda afatit të caktuar prej 4 (katër) muajsh, Gjykata i referohet datës së pranimit të vendimit të fundit nga ana e parashtrueses dhe datës së dorëzimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

32. “Vendimi i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit, normalisht do të jetë vendimi i fundit me të cilin ishte refuzuar padia e parashtruesve (Shih mutatis mutandis *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, GJEDNJ, Vendim i 14 marsit 2002). Afati fillon të llogaritet nga vendimi i plotfuqishëm, si rezultat i shterjes së mjeteve adekuate dhe efektive për të siguruar korrigjimin e çështjes, që është objekt i ankesës (Shih mutatis mutandis *Norkin kundër Rusisë*, Kërkesa 21056/11, GJEDNJ, Vendimi i 5 shkurtit 2013 dhe shih, gjithashtu, *Moya Alvarez kundër Spanjës*, nr. 44677/98, GJEDNJ, Vendimi i 23 nëntorit 1999).

33. Përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të dorëzuar te Prokurori i Shtetit, Gjykata vëren se Prokurori i Shtetit, duke iu referuar dispozitave në fuqi, vëren se parashtruesja *“sipas nenit 245.3 të LPK nuk lejohet një kërkesë e tillë kundër vendimit gjyqësor me të cilin është vendosë lidhur me revizionin”.*

34. Gjykata vëren se neni 245, paragrafi 3, i Ligjit për procedurën kontestimore parasheh:

“Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk lejohet kundër vendimit që me rastin e revizionit ose të kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka marrë gjykata me kompetencë për të vendosur për këto mjete juridik”.

35. Në rrethanat e rastit konkret, është e qartë se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ka qenë mjet efektiv juridik dhe se nuk mund të kishte pritshmëri legjitime për suksesin e këtij mjeti, sepse qartazi me ligj ishte përcaktuar se ai mjet juridik i jashtëzakonshëm nuk ishte i lejueshëm të ushtrohej.
36. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se vendimi i fundit në rastin konkret është aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 272/14 dhe afati fillon të llogaritet nga dita e pranimi të aktvendimit të lartpërmendur nga ana e përfaqësuesit të parashtruesve (Shih *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 38587/97, GJEDNJ, Vendimi i 29 janarit 2002) dhe nuk mund ta marrë në konsideratë njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit.
37. Prandaj, nga parashtruesat rezulton se përfaqësuesi i parashtruesve Aktvendimin e Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën për revizion e ka pranuar më 23 dhjetor 2014, dhe kjo vërtetohet nga vula e shtypur pranuese në ballinën e vet Aktvendimit, ndërsa parashtruesit e kanë dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 10 gusht 2015 (shih, ndër të tjera, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese KI201/13, të parashtrueses *Sofa Gjonbalaj*, të 17 prillit 2013).
38. Në rrethanat kur kërkesa është e paafatshme, Gjykata nuk mund të shqyrtojë pretendimet e ngritura lidhur me shkeljet e pretenduara të së drejtës për gjykim të drejtë në të gjitha elementet e sajë e as të drejtës së pronës, të mbrojtura me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
39. Bazuar si më sipër, rrjedh se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe duhet të deklarohet e papranueshme, sepse është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 20 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arteta Rama-Hajrizi